



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. HEKURAN TROKA”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Familja Troka, përbëhet nga katër anëtarë dhe jetojnë në lagjen “Clirim”, Berat, në një apartament të të afërmeve, banesë e përshtatëshme për të jetuar. Strukturat e Shërbimit Social, administratori shoqëror i Rajonit 1 pasi administruan kërkesën e z.Hekuran Troka prindi i dy fëmijëve të mitur fëmijës, kryhen vizitën në familje dhe vlerësuan nevojat social-ekonomike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Familja prej vitesh trajtohet me shërbime mbështetëse nga Shërbimi Social, si familje në vështirësi ekonomike dhe në përbërje të dy prindërit me aftësi ndryshe, të cilët kanë dëmtim në të dëgjuar dhe ju nevojiten mjete ndihmëse. Duke qënë se dëmtimi i aftësive funksionale për të dy prindërit është i moderuar, kanë vështirësi në integrimin në punë.

Fëmijët ndjekin arsimin por mungesat financiare ndikojnë në vazhdimësinë dhe cilësinë e arsimit. Për këtë shkak për ta është shumë e vështirë të sigurojnë nevojat bazike për të dy fëmijët dhe të përballojnë jetesën, pasi të ardhur të vetme kanë mbështetjen financiare mujore për personat me aftësi të kufizuar. Bazuar në informacionin e mbledhur dhe verifikimet e dokumentacionit përkatës, familja ndodhet në kushte të vështira social ekonomike, pas analizës se të ardhurat janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë jetike, duke e vendosur familjen në situatë vështirësie ekonomike.

Situata Financiare

Të ndodhur në këto kushte dhe vështirësi, duke u bazuar dhe në kërkesën e bërë nga z.Hekuran Troka, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat ekonomike nga strukturat e shërbimit social, kushtet ku jeton familja, propozojmë që z.Hekuran Troka të mbështetet në masën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë .

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky material nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 27/02/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. HEKURAN TROKA**”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste të veçanta, për shtetasin Hekuran Troka në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë .
2. Shuma prej **60.000 (gjashtëdhjetë mijë)** lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 27/02/2026